




## MEMORANDUM BASHKPUNIMI

NDËRMJET



KOMUNËS SË KLINËS

DHE

SHOQATËS SË KOSOVËS PËR KERKIM-SHPËTIM

PËR

BASHKPUNIM NË FUSHËN E EMERGJENCVAE CIVLIE  
DHE TRAJNIMEVE SPECIFIKE

Maj 2023 Klinë



I. Komunën e Klinës të cilën e përfaqëson, Prof.Dr Zenun Elezaj  
në njërën anë,

si dhe

II. Shoqatën e Kosovës për Kërkim Shpëtim të cilën e përfaqëson z.Milaim  
Kelmendi, Nënkrjetar i SHKKSH , referuar si " PALËT " janë pajtuar të  
lidhin këtë:

## MEMORANDUM BASHKPUNIMI

### Neni 1

Fushëveprimi i Shoqatës së Kosovës për Mbrojtje dhe Shpëtim

SHKKSH është regjistruar me dt. 20/01/2022, Nr. i Regj. 5119428-4 me Nr. Fiskal 602647953 dhe realizon veprimet dhe interesat e saj, duke bashkëpunuar me organizata, institucione shtetërore, shoqata, klube, iniciativa dhe individë. SHKKSH ka vullnet dhe aftësi profesionale në fushën e Kërkim Shpëtimit në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike, të cilat do të bashkërendohen aktivitetet e kërkim shpëtimit me struktura tjera me qëllim që të ruhet rëndësia për ndërhyrje të shpejtë dhe efektive në shpëtimin e njerëzve dhe të mirave materiale, që në tërësi do ti shërbente interesit të përgjithshëm publik.

### Neni 2

#### Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandumi të bashkëpunimi në mes të Komunës së Klinës ( NjPMSH) dhe Shoqatës së Kosovës për Kërkim Shpëtim ka për qëllim bashkëpunimin në fushën e emergjencave civile dhe trajnimeve specifike që Shoqata e Kosovës për Kërkim Shpëtim ka mundësi ti ofroj :

- ✓ në fushën e kërkim shpëtimit malor,
- ✓ në fushën e kërkim shpëtimit urban,
- ✓ në fushën e kërkim shpëtimit në tërmete,
- ✓ në fushën e kërkim shpëtimit nga humnera,
- ✓ në fushën e kërkim shpëtimit në shpella,
- ✓ në fushën e kërkim shpëtimit ujor ( zhytje) dhe vërshimet,
- ✓ në fushën e kërkim shpëtimit nga orteqet e borës,

dhe çfarëdo terreni tjetër qoftë për shkak të fatkeqësive natyrore apo fatkeqësive të shkaktuara nga njeriu.

Komuna e Klinës ti ofroj Shoqatës së Kosovës për Kërkim Shpëtim, mbështetje në mjete, pajisje, resurse apo shfrytëzimin e pajisjeve dhe terreneve për mbrojtje.

### Neni 3

## Natyra jo detyruese

Qëllimi i memorandumit nuk është i kufizuar vetëm në shprehjen e vullnetit të palëve për bashkëpunim të ndërsjellët dhe nuk synon të vendos ndonjë detyrim financiar me përjashtim angazhimeve brenda dhe jashtë vendit sipas ligjeve në fuqi .

### Neni 4

#### Bashkëpunimi dhe Partneriteti

1. Palët bien dakord të ndihmojnë, promovojnë, mbështesin dhe zgjerojnë bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet palëve, në mënyrë që të ofrojnë masa për të mbështetur lëmin e Kërkim Shpëtimit sipas misionit që ka SHKKSH-ja
2. Palët bien dakord të shkëmbejnë ekspertët dhe ekspertizat e tyre në fusha të caktuara me qëllim të arritjes së objektivit dhe ngritjes së gatishmërisë të reaguesve të parë.

### Neni 5

#### Përgjegjësitë e Palëve

Komuna e Klinës ka këto përgjegjësi:

- 5.1. Emërtimin e një qendre të kujdestarisë nga e cila do aktivizoheshin resurset dhe stafi i SHKKSH përmes numrit +383-45-112-102 i cili numër do jetë edhe kujdestar i SHKKSH 24/7,
- 5.2. Komuna e Klinës duhet të caktoj një Koordinator i cili duhet ti koordinoj aktivitetet me SHKKSH,
- 5.3. Komuna e Klinës duhet ti ofroj SHKKSH pajisje të specializuara nëse SHKKSH nuk posedon,
- 5.4. Komuna e Klinës në rast të ndonjë trajnimi duhet të përgatis program të trajnimeve në bashkëpunim me SHKKSH në fushën e Kërkim Shpëtimit dhe ta njoftoj me kohë SHKKSH,
- 5.5. Komuna e Klinës për aktivizimin e SHKKSH duhet siguroj mbështetje për SHKKSH në rast të aktivizimit sipas ligjit për FNFT për organizata vullnetare.

SHKKSH ka këto përgjegjësi:

- 5.6. Të emërojë pjesëtarin e SHKKSH kujdestar i cili do ta mbaj telefonin e hapur 24/7 dhe ti lajmërohet qendrës së kujdestarie apo Koordinatorit komunal ,
- 5.7. Pjesëtari kujdestar për aktivizimin e njërive në mbështetje të Komunës së Klinës merr urdhra vetëm nga Koordinatori i QK ,
- 5.8. Udhëheqësi i Departamentit është përgjegjës që ekipin në fushën ekzakte që ta kompletoj dhe të jetë në gjendje gatishmërie me pajisje adekuate,
- 5.9. Udhëheqësi i Departamentit është përgjegjës për huazimin dhe kthimin e pajisjeve nga Komuna e Klinës,
- 5.10. Udhëheqësi i Departamentit është përgjegjës për sigurinë e pajisjeve,

5.11. Udhëheqësi i Departamentit është përgjegjës për sigurinë e pjesëtarëve të SHKKSH.

Përgjegjësitë e përbashkëta të palëve:

- 5.12. Palët kanë përgjegjësi të promovojnë së bashku masat për grupin/targetin e synuar,
- 5.13. Palët mund të zhvillojnë aktivitete të tjera me interes të përbashkët,
- 5.14. Palët mund të organizojnë ushtrime të përbashkëta,
- 5.15. Palët mund të organizojnë tryeza, seminare dhe sensibilizime-ndërgjegjësimë nëpër institucione shkollore dhe jo vetëm,

#### Neni 6 Hyrja në fuqi

1. Ky memorandum i Bashkëpunimi nënshkruhet në tre (3) kopje në gjuhën shqipe dhe serbe.
2. Kohëzgjatja e këtij Memorandumi është me kohë të pa përcaktuar, duke filluar nga hyrja e tij në fuqi,
3. Versioni në shqip ofrohet si përkthim. Në rast të mospërputhjes midis dy versioneve, do të mbizotërojë version shqip ,
4. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Palët nënshkruese të përfaqësuara nga:

Prishtinë, me datë 22/05/2023

Nën Kryetar i SHKKSH

Milaim Kelmendi



Kryetari i Komunës së Klinës

Prof. dr. Zenun Elezaj

